



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2019

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për “**Sark**” sh.p.k me adresë: Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skëndërbej, Rajoni nr 3, Përballë supermarket Lalaj, Fier.

Procedura e prokurimit: “**Kërkesë për propozim**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-22749-05-20-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti II: “Sistemim i përroit të Balldrenit, Fshati Balldren dhe fshati Vidhas, Njësia Administrative Papër”, me fond limit: 1,432,828 (një milion e katërqind e tridhjetë e dymijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkise për vitin 2019, dhe me afat për kryerjen e punimeve **10 ditë nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Fled” sh.p.k me Nipt: K 17621104 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,242,080** (një milion e dyqind e dyzet e dymijë e tetëdhjetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **1,490,496** (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë** (me tvsh).

2. “Sark” sh.p.k. me Nipt: K 52531415 H

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,197,720** (njëmilion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e njëzet) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **1,437,264** (njëmilion e katërqind e tridhjetë e shtatëdhjetë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) **lekë** (me tvsh).

3. “Shamo - Construction” sh.p.k. me Nipt: L 01326020 F

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,419,520** (njëmilion e katërqind e nëntëmbëdhjetëdhjetë e pesëqind e njëzet) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **1,703,424** (njëmilion e shtatëqind e tremijë e katërqind e njëzet e katër) **lekë** (me tvsh).

4. “Sardo” sh.p.k. me Nipt: K 13120402 W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,064,640** (njëmilion e gjashtëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dyzet) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **1,277,568** (njëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë** (me tvsh).

5. “Bajrami N” sh.p.k. me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,140,052** (njëmilion e njëqind e dyzetmijë e pesëdhjetë e dy) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **1.368.062,4** (njëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e tetëdhjetë e dy presje katër) **lekë** (me tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Sardo” sh.p.k me Nipt: K 13120402 W

2. Operatori ekonomik “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Sardo” sh.p.k skualifikohet për arsye se :

a) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.2 te Kapacitetit ekonomik dhe financiar, pika b:

Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik.

Operatori ekonomik ka paraqitur nje vertetim nga OSHE per detyrimet e faturave te

energjië elektrike dhe rezulton qe faturimi per muajin Prill eshte i papaguar.

b) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3 te Kapacitetit Teknik, pika 2.3.1:

b.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se **716,414** (*shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e katërmbëdhjetë*) **lekë pa t.v.sh.**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit , nga data e zhvillimit te tenderit;

c) OSE

b- Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit , nga data e zhvillimit te tenderit është një vlerë jo më e ulët se **2,865,656** (*dymilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë*) **lekë pa t.v.sh.;**

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: Kontratën, lejen e ndërtimit, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit, lejen e përdorimit, faturën tatimore të deklaramit të objektit në organet tatimore.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Puna e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik eshte ekzekutuar ne nje periudhe kohe me te hershme sesa afati kohor i percaktuar ne piken e kriterit te vecante, pra nuk eshte brenda tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

d) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.4 te Kapacitetit Teknik :

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per te pakten **3 (tre) muajt e fundit**, si mëposhtë:

- Ing. Ndërtimi **1** (një)
- Referuar listepagesave te shoqerise SARDO te paraqitura ne SPE per muajin prill 2019, si dhe bazuar VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR" rezultojne se:

1. Kozma Shqepa i deklaruar nga OE si inxhinier ndertimi , me kod 2142.25 figuron te jete inxhinier per sistemet e ujitjes .

e) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.6 te Kapacitetit Teknik :

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhët të paraqesin kontratat individuale të punës të vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës që prokurohet dhe dëshmitë e drejtimit të leshuara nga D.P.SH.T Rrugore, për të paktën **2 (dy) manovratorë** të makinave të rënda.

- Operatori Ekonomik ka deklaruar 4 manovrator dhe referuar listepagesave te shoqerise SARDO te praqitura ne SPE per muajin prill 2019, si dhe bazuar VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR" rezultojne se:

1. Axhem Qalliaj dhe Emiljano Braka jane deklaruar nga OP si manovrator , me kod 8331.03 figurojne te jene shofer per makina me karrocери.

2. Klodian Hazizi eshte deklaruar nga OP si manovrator , me kod 8322.01 figuron te jete Drejtues per makinat e bankave.

3. Remzi Hazizi eshte deklaruar nga OP si manovrator , me kod 8332.14 figuron te jete shofer kamioni.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

2. Operatori ekonomik “Bajrami N” sh.p.k skualifikohet për arsye se :

a) Operatori Ekonomik ne permbushje te pikes 2.3.8 te Kapacitetit Teknik, pika c :

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

Operatori ekonomik ka deklaruar se i disponon te gjitha mjetet e kerkuar per realizimin e kontrates dhe nuk i ka te angazhuara ne kontrata te tjera por nga verifikimi rezulton se:

1.Eskavator me Zinxhir me Nr.Shasise 366ML0214

2. Eskavator me Zinxhir me Nr.Shasise 5MS00415

3.Kamion vetshkarkues minimalisht 10 ton me targe AA209NE dhe nr. lejes qarkullimit ELD0003616

4. Kamion vetshkarkues minimalisht 1-2 ton me targe AA946PU dhe nr. lejes qarkullimit ELD0358917

5. Kamion vetshkarkues minimalisht 1-2 ton me targe EL9638B dhe nr. lejes qarkullimit EL0008517

Keto mjete jane te angazhuara dhe do te perdoren ne kontraten e lidhur me Autoritetin Kontraktor , Bashkia Elbasan ne objektin: “Rikonstruksioni i rrugeve “Ymer Stringa”+ rruga “Mithat Stringa” + rruga “Ismail Haxhimusaj” dhe sheshet e pallateve ,579, 579/3, 579/4, 579/5, 580/1, kontrate e lidhur ne date 07.06.2019.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: “**Sark**” sh.p.k me adresë: Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skëndërbej, Rajoni nr 3, Përballë supermarket Lalaj, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1,197,720** (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anullovë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 12.06.2019

Ankesa nuk ka patur.



TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Vesa Liço